




REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, nenit 13 të Rregullores për ndarjen subvencioneve 15Nr.-011-43473 e datës 28.06.2019, nenit 12 të Rregullorës për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre, 15Nr.011-71878 të datës 27.11.2018, si dhe Vendimit për përcaktimin e shumës për ndarjen e mjeteve financiare për mbulimin e shërbimeve të varrimit, 15Nr.400-71876 të datës 27.11.2018, duke vendosur sipas kërkesës 1Nr.400-18242 të datës 18.05.2020, Kryetari i Komunes nxjerr këtë:

**VENDIM  
PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE**

**Neni 1**

Ndahet shuma e mjeteve në vlerë prej **170 €** (njëqind e shtatëdhjet euro), për të mbështetur financiarisht mbulimin e shpenzimeve të varrimit për të ndjerin Shaban Sadiku nga fshati Babush i Muhaxherëve, sipas kërkesës së vajzës së tij Mirvete Sadiku të datës 18.05.2020.

**Neni 2**

Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2020, pozicioni buxhetor- subvencionet e planifikuara për Zyrën e Kryetarit të Komunës në xhirollogarinë bankare të paraqitëses së kërkesës nr.XK051907001582021114 në BKT.

**Neni 3**

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Zyra e Kryetarit të Komunës dhe Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

**Neni 4**

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Mirvete Sadiku nga Babushi i Muhaxherëve.

1Nr. 400-18242  
Lipjan, më 20.05.2020

KRYETARI I KOMUNËS  
Imri Ahmeti